



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
KESHILLI I BASHKISE

B.Curri, më 25.01.2018

VENDIM 11

“Per nje ndryshim ne Vendimin nr.100 date 15.12.2017 ”Per miratimin e buxhetit dhe numrit maksimal te punonjesëve te Bashkisë Tropoje per vitin 2018”

Keshilli i Bashkise Tropoje ne mbledhjen e tij te dt.25.01.2018 Bazuar ne ligjin Nr.139/2015 dt 17.12.2015 “Per veteqevirsjen vendore” neni 54 germa “dh”, Ligjin 9936 dt.28.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetor ne republiken e shqiperise” Ligjin nr.68/2017 “per financat e vetqeverisjes vendore” Shkresen e Ministrisë Financave dhe ekonomise Nr.14881/2 prot. dt.27.10.2017” Dergim per njoftim te transfertes pakushtezuar dhe specifike per vitin 2018” pasi shqyrtoj projektë vendimin e paraqitur nga sektori i burimeve njerzore per miratimin e nje shtese prej 4(kater) punonjesish me kontrate te perkohshme pune ne Bashki.

V E N D O S I

- 1- Te miratoj nje shtesë prej 4 punëtorësh me kontrate pune te perkohshme, ne numrin e pergjithshem te punonjesve te miratuar me vendimin nr 100 dt. 15.12.2017
- 2- Kjo shtese e numrit punetoreve me kontrate pune te perkohshme miratohet per mirmbajtjen e kontrollin e kanaleve të ujitjes se tokave bujqesore, pergjate periudhes verës.
- 3- Efektet financiare per kete shtesë te numrit punetoreve te perkohshme perballohen nga fondi i pagave i miratuar me vendimin 100 dt.15.12.2017.
- 4- Ky vendim hynë ne fuqi menjeherë dhe shtrin efektet pas konfirmimit nga institucioni i Prefektit.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rubin Sellaj

KRYETARI I KËSHILLIT

Imer Hoxha

